



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** e Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1, shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.02.2021, merr këtë

V E N D I M

- I. MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të: Arbër (Ejup) Nezirit, Fatos Nezirit, Flamur (Ymer) Nezirit, Adelina (Ymer) Nezirit, Ahmet (Isak) Nezirit, Bajram Nezirit, Mustafë (Isak) Nezirit dhe Mehmet (Isak) Nezirit.
- II.** Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesë e parcelës kadastrale nr. P-71914059-07703-0, Zona kadastrale, Prishtinë, në pronësi të PSH, rrugë, KK Prishtinë, me destinim ndërtim dhe pjesa e mbetur kalon në blloqet “T 9”, “T 11”, “T 5”, “T 1”, “T 3”, “T 4”, sipas Planit rregullues “Tophane”, i miratuar me Vendimin për miratimin e Planit rregullues për lagjen “Tophane” në Prishtinë, 01. nr. 35-579, dt. 22.11.2005, plotësuar me Vendimin për plotësimin dhe mënyrën e realizimit të Planit rregullues të lagjes “Tophane” në Prishtinë, 01. nr. 35-374, dt. 03.04.2008, kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, është pjesë e parcelës kadastrale, nr. P - 71914059-10353-5, Zona kadastrale, Prishtinë në pronësi të Arbër (Ejup) Nezirit, Fatos Nezirit, Flamur (Ymer) Nezirit, Adelina (Ymer) Nezirit, Ahmet (Isak) Nezirit, Bajram Nezirit, Mustafë (Isak) Nezirit, Mehmet (Isak) Nezirit, me destinim infrastrukturë rrugore, planifikuar sipas Planit rregullues “Tophane”, i miratuar me Vendimin për miratimin e Planit Rregullues për lagjen “Tophane” në Prishtinë, 01. nr. 35-579, dt. 22.11.2005, plotësuar me Vendimin për plotësimin e mënyrës së realizimit të Planit rregullues të lagjes “Tophane” në Prishtinë, 01. nr. 35-374, dt. 03.04.2008.
- III.** Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë, pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit rregullues “Tophane” në Prishtinë.
- IV.** Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V.** Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbëhet.
- VI.** Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbëhen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.
- VII.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

Arsyetim

Drejtoria e Urbanizmit, me Vendimin për caktimin e kushteve ndërtimore për këmbim, nr. 05, nr. 350/03-99834/20, dt. 14.10.2020, ka dhënë Pëlqimin për këmbimin e pjesës së parcelës kadastrale nr. 07703-0, me sipërfaqe prej 66m², ZK, Prishtinë, në pronësi të PSH, rrugë, KK Prishtinë dhe pjesën e parcelës nr. 10353-5, me sipërfaqe prej 66m², ZK, Prishtinë, në pronësi të Arbër (Ejup) Nezirit, Fatos Nezirit, Flamur (Ymer) Nezirit, Adelina (Ymer) Nezirit, Ahmet (Isak) Nezirit, Bajram Nezirit, Mustafë (Isak) Neziri dhe Mehmet (Isak) Nezirit, e cila gjendet në kuadër të bllokut urban "T 9" të Planit rregullues "Tophane", i miratuar me Vendimin për miratimin e Planit rregullues për lagjen "Tophane" në Prishtinë, 01. nr. 35-579, dt. 22.11.2005, plotësuar me Vendimin për plotësimin e mënyrës së realizimit të Planit rregullues të lagjes "Tophane" në Prishtinë, 01 nr. 35-374, dt. 03.04.2008.

Propozimi për inicimin e këmbimit të parcelës/ave të tokës me pronarët e cekur në pikën II, është bërë për shkak të realizimit të Planit rregullues "Tophane", i miratuar me Vendimin për miratimin e Planit rregullues për lagjen "Tophane" në Prishtinë, 01. nr. 35-579, dt. 22.11.2005, plotësuar me Vendimin për plotësimin e mënyrës së realizimit të Planit rregullues të lagjes "Tophane" në Prishtinë, nr. 01, nr. 35-374, dt. 03.04.2008.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private, është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, pasi Komuna nuk ka pronë të vetën për implementimin e projekteve të lartcekura.

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private, siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.

Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:

- skica grafike,
- kopjet e planit
- certifikatat e njësisë kadastrale,
- Vendimi për miratimin e Planit rregullues për lagjen "Tophane", Vendim për plotësimin e mënyrës së realizimit të Planit rregullues të lagjes "Tophane" në Prishtinë,
- Destinimi për parcelat kadastrale nr. 07703-0 dhe nr. 10353-5, ZK, Prishtinë, nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm,
- Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/01-27281/21, më 11.02.2021

KRYESUESI I KUVENDIT

Agim Kuleta

